



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:130891
Datë: 29.09.2020
Numri i dokumentit: 01149743

C.nr.98/19

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Mirlinda Bytyqi Rexhepi, në çështjen juridike të paditëses Kompania e Sigurimeve “P...” SH.A, të cilën e përfaqëson me autorizim Ardiana Bejtullahu nga Prishtina, kundër të paditurit SH.H nga fshati ... Komuna Ferizaj, në çështjen juridike rimbursim dëmi, të cilën e përfaqëson përfaqësuesja e përkohshme av.Editë Shahini nga Ferizaj, pas shqyrtimit kryesor të mbajtur, më datë 22 Shtator 2020, në prezencën e përfaqësuesit të paditëses dhe të përfaqësueses së përkohshme për të paditurin av. Editë Shahini, mori ndërsa me datë 29 Shtator 2020 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi kërkesë padia e paditëses Kompania e sigurimeve “P...” me seli në Prishtinë, si e bazuar.

II. DETYROHET i padituri SH.H nga Fshati ... Komuna Ferizaj që paditëses në emër të rimbursimit të dëmit t'i paguajë shumën prej 1.000 euro (njëmijë euro), me kamatë ligjore 8 % nga dita e paraqitjes së padisë datë 05.02.2019, deri në pagesën përfundimtare, të gjitha në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë, si dhe shpenzimet e procedurës dhe atë shumë prej 259 € dhe atë 239 euro për shpenzimet për përfaqësues të përkohshëm dhe 20 euro për taksë gjyqësore.

III.OBLIGOHET paditësja që përfaqësueses së përkohshme ti paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 239 euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m i

Më datë 05 Shkurt 2019 paditësja K.S “P...” nga Prishtina në këtë gjykatë ka ushtruar padi ndaj të paditurit SH.H nga Fshati Manastirce K. Ferizaj, për rimbursimin e dëmit lidhur me aksidentin e datës 29.12.2017.

I padituri SH.H nuk ka qenë prezentë në seancën gjyqësore, edhe pse i njëjti është ftuar për disa seanca gjyqësore, ndërsa ftesat janë kthyer me arsyetimin se ai gjendet jashtë vendit. Andaj, gjykata me propozimin e përfaqësuesit të paditëses sipas aktvendimit procedural e konform nenit 79 par.3 me të cilin përcaktohet” Gjykata ti caktoj palës së paditur përfaqësuesin e përkohshëm në rast se vendqëndrimi i të paditurit është i panjohur, kur i padituri nuk ka përfaqësues të autorizuar”, ka vendosur që në seanca gjyqësore i padituri SH.H të përfaqësohet nga përfaqësuesja e përkohshme.

Lidhur me këtë, gjykata ka caktuar seancën gjyqësore më datë 22 Shtator 2020, në të cilën seancë përfaqësuesi i paditëses ka mbetur pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke theksuar se nga provat e bashkangjitura padisë vërtetohet baza juridike e kërkesëpadisë, fillimisht në bazë të raportit të policisë nr.2017-CF-2901 është përshkruar qartë se aksidenti ka ndodhur me lëshimet e të paditurit SH.H , me arsyetimin se i padituri ditën kur e ka shkaktuar aksidentin ka qene duke vozitur pa patentë shofer, e që po ashtu i njëjti ka vepruar në kundërshtim me rregullat e komunikacionit rrugor dhe i ka shkaktuar dëme materiale të dëmtuarës A.SH, si vozitës i automjetit Opel Aastra me targa ... ngjyre hiri, pronarit të automjetit tjetër BMW X-drive A.SH me targa ... ngjyre e bardhë, të cilën e ka kompensuar tani paditësja, e cila në bazë të nenit 18 pika 4 të LSDA ka të drejte të bëj regresimin e mjeteve nga shkaktari i aksidentit. I ka propozuar gjykatës që ta aprovon kërkesëpadinë si të bazuar.

Përfaqësuesja e përkohshme të paditurit av. Edite Shahini në përgjigje në padi dhe në fjalën përfundimtare e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadisë, pretendimet e paditëses i ka konsideruar si të paargumentuar me prova dhe fakte për faktin se e njëjta deri tani nuk ka deponuar në gjykatë vendimin gjyqësor mbi të cilin i padituri të jetë shpallur përgjegjës, i ka propozuar gjykatës që e njëjta të merr vendim meritore në këtë çështje, i ka kërkuar shpenzimet dhe atë për përgjigje në padi 104 euro, për 1 seancë gjyqësore 135 euro, pra shumën totale në vlerë 239 euro.

Për të vërtetuar gjendjen faktike, gjykata ka vazhduar me administrimin e provave dhe atë, janë administruar : Padia C.nr. 98/129 e dt.05.02.2019, raporti policor i aksidentit me nr. 2017-

CF2901 i dt. 29.12.2017, Ujdi jashtëgjyqësore dt.18.05.2018 ,Procesverbal mbi dëmtimin e automjetit dt.16.04.2018 , Përgjigjja në padi dt.03.07.2020, Përshkrimi i transaksionit , Prokure e-mail elektronik, aktvendim për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm në tri gjuhë.

Bazuar në provat e administruara dhe vlerësimit të tyre, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjykata ka vërtetuar se kërkesëpadia është e bazuar.

Gjykata me rastin e vlerësimit të bazueshmërisë së kërkesëpadiës, konsideron se e njëjta bazohet në provat e administruara dhe atë: nga raporti policor i dt. 29.12.2017, në të cilën mes tjerash është konstatuar se deri te aksidenti ka ardhur kur automjeti "A" të cilin e drejtonte SH.H cili ka vepruar në kundërshtim me rregullat e komunikacionit rrugor dhe i ka shkaktuar dëme material të dëmtuarës A.SH, si vozitës i automjetit Opel Astra me targa ... , të cilën e ka kompensuar tani paditësja.

Sa i përket dëmeve materiale, K.S "P...", Prishtinë duke vepruar konform Ligjit për Sigurimin nga Autopërgjegjësia Nr.04/1-018, të dëmtuarës i ka kompensuar dëmin material të pësuar si rezultat i aksidentit.

Lidhur me bazën juridike rreth themelësisë së kërkesëpadiës së paditësit, Gjykata ka gjetur se e njëjta bazohet në Ligjit Për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autpërgjegjësia Nr.04/L-018, dhe atë fillimisht bazuar në nenin 18 paragrafi 1, në të cilën parashihet e drejta e personit të dëmtuar ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja. Në ndërlidhje më këtë e drejta e Byrosë (BKS-së) për rimbursimin e dëmit rrjedh nga i njëjti nen paragrafi 4, në të cilën përcaktohet *'Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat'*.

I padituri në momentin e aksidentit ka pasur të kontraktuar sigurimin vullnetar KASKO, ashtu që kompania pas përmbushjes së detyrimit nga sigurimi vullnetar KASKO, me anë të institutit të subrogimit i cili parashihet me nenin 960 të LMD-së ka fituar të drejtën për të paraqitur kërkesë për kompensim dëmi tek paditësi.

Rrjedhimisht, bazuar në këto argumente (sa i përket gjendjes faktike dhe aplikimit të së drejtës materiale) Gjykata ka konstatuar se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe për të njëjtën e ka obliguar të paditurin ta bëjë rimbursimin e dëmit në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite, ashtu siç është urdhëruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata në lartësinë e aprovuar të shpërblimit të dëmit paditëses ja ka njohur të drejtën në kamatës ligjore 8 %, nga dita e paraqitjes së padisë dt.05.02.2019 deri në pagesën definitive.

Vendimin për shpenzimet e procedurës, gjykata e ka bazuar në kuptim të nenit 452 të LPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

C.nr.98/19 me datën 29 shtator 2020

Gjyqtarja

Mirlinda Bytyqi Rexhepi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.